

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM

Midis

Kolegji-t “Universum”

Dhe

Drejtësi për të gjithë

1. Qëllimi i marrëveshjes

Me këtë marrëveshje palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, ndarjen e përvojave në fushën e edukimit dhe organizimeve;

Palët e kësaj marrëveshje, zotohen për bashkëpunim në fusha të ndryshme, që ndërlidhen me aktivitetet e edukimit dhe avancimin e mësimnxënies përmes metodave të reja dhe arritjes së një ambienti ku të gjithë kanë qasje në arsimim dhe zhvillim të mëtutjeshëm pa diskriminim, mbështetur në parime të Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, pika (f) dhe nenit 12, paragrafi 2, pika (d) e Statutit të Kolegjit “Universum” si dhe në pajtim me vlerësimin e komisionit të formuar për ndarjen e bursave në kuadër bashkëpunimit nder institucional Kolegji Universum ka marrë vendim për ndarjen e 5 (pesë) bursave në vlerë 100% (njëqind për qind) ose në vlerë 3600EUR (tre mijë e gjashtëqind Euro) për studime themelore Bachelor, për anëtarët e Drejtësi për të gjithë.

Kolegji Universum është i obliguar që me rastin e përzgjedhjes së përfituesve t'i ndajë 5 bursa studimi për vitin akademik 2020/2021 (në vlerë 100%, në drejtimet që Kolegji Universum ofron për studime):

- në programin **Shkenca Kompjuterike**
- në programin **Biznes dhe Menaxhment**
- në programin **Shkenca Politike**
- në programin **Gjuhë Angleze**

si Bursa të tjera për vitin akademik 2020/2021 në vlerë 50% (pesëdhjetë përqind) për të gjithë të interesuarit e tjerë, për katër drejtimet e lartpërmendura:

- në programin **Shkenca Kompjuterike**
- në programin **Biznes dhe Menaxhment**
- në programin **Shkenca Politike**
- në programin **Gjuhë Angleze**

Kriteret

Bursa shfrytëzohet për studime në Kolegjin Universum, pra për Bursat e plota studenti nuk ka ndonjë obligim financiar të kështit mujor, ndërsa për Bursat 50% (pesëdhjetë përqind) bëhet zbritje nga shuma totale për një vit akademik.

Bursa vlen për tri vite të studimit sipas kriterëve të nënshkuara me kontratë për studime.

Modifikimi/ Përfundimi

Çfarëdo ndryshimi/ plotësim i dispozitave të kësaj marrëveshje do të bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët e marrëveshjes. Ndryshimet/ plotësimet do të përcillen me një tekst të arsyeshmërisë për ndryshimin/ plotësimin që i dorëzohet secilës palë të marrëveshjes. Çdo mosmarrëveshje do të zgjidhet me frymën e mirëkuptimit në mes të dy palëve.

Hyrje në fuqi

Marrëveshja hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga e palëve të kësaj marrëveshjes.


Palët nënshkruese:

Drejtimi për të gjithë

Datë: 08/10/2020



Kolegji UNIVERSUM


Datë: 08/10/2020